



PROGRAMI I PROVIMEVE TE AFTESISE PROFESIONALE PER KANDIDATET QE APLIKOJNE PER MARRJEN E TITULLIT

- “EKSPERT KONTABËL I REGJISTRUAR”,¹
TË MJAFTUESHME EDHE PËR MARRJEN E TITULLIT
- “KONTABILIST I MIRATUAR”²

I. KONTABILITETI, RAPORTIMI FINANCIAR DHE ANALIZA E PASQYRAVE FINANCIARE.

1. Kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar në Republikën e Shqipërisë³

- Kërkesat ligjore për Kontabilitetin dhe raportimin financiar;
- Kërkesat, objektivat, parimet e përgjithshme, rregullat kryesore të mbajtjes së kontabilitetit dhe të raportimit të informacioneve financiare nga entitetet që ndjekin qëllime fitimprurëse dhe jo fitimprurëse;
- Standardet e raportimit që zbatohen nga kategori të ndryshme të entiteteve.

Literatura:

- *Ligji për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare Nr. 9228 dt. 29.04.2004, me ndryshimet.*
- *Vendimi i KM Nr 742 datë 07.11.2007. "Për kriteret e përzgjedhjes së njësisve ekonomike, që duhet të zbatojnë standardet ndërkombëtare të kontabilitetit"*

2. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (të përmirësuara) (SKK-të)⁴

- Trajtimi kontabël i elementëve të pasqyrave financiare sipas SKK - ve, njohja, matja, politikat kontabël, gabimet, cmuarjet, ngjarjet pas datës së bilancit paraqitja e elementëve në pasqyrat financiare, shënimet shpjeguese, etj.;
- Përgatitja dhe paraqitja e pasqyrave financiare individuale dhe të konsoliduara sipas standardeve kombëtare e ndërkombëtare të kontabilitetit.

¹ Sipas Ligjit 10091 dt.5.03.2009 për titullin EKR kandidatët duhet të kalojnë me sukses të gjithë provimet e parashikuara në program (I, II, III, IV dhe V).

² Sipas Ligjit 10091 dt.5.03.2009 për titullin KM kandidatët duhet të kalojnë me sukses vetëm dy provimet e para (I dhe II).

³ Parashikohet që në tezën e provimit kjo pjesë e programit të përfshijë 5% të pikëve.

⁴ Parashikohet që në tezën e provimit kjo pjesë e programit të përfshijë 60% të pikëve.

Literatura:

- *Standardet kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara (2014), të publikuara në faqen e internetit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit në adresën www.kkk.gov.al ose në faqen e internetit të ministrisë së financave www.financa.gov.al (SKK 1 – SKK 15).*

3. Njohuri për Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNK/SNRF)⁵

- Njohuri bazë për SNRF-të (Kryesisht njohuri bazë konceptuale për SNRF-të (SNRF 1- SNRF 15))

Literatura:

Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit (SNK/SNRF të publikuara nga IASB) të përkthyer në shqip nga KKK dhe të publikuar në faqen e internetit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit në adresën www.minfin.gov.al.

4. Kontabiliteti i Kostos dhe i Drejtimit⁶

- Roli i Kontabilitetit të Drejtimit. Kuptimi i Kostos dhe klasifikimi i saj për qëllime të vendim-marrjes.
- Sistemet e llogaritjes së kostos (prodhimi individual, prodhimi i vazhdueshëm dhe kosto e kontraktuar).
- Metodatat e llogaritjes së kostos (kosto e plotë dhe kosto direkte) bazat e metodës ABC.
- Buxhetimi dhe sistemi i kostos standarde.

Literatura:

Teksti ose leksionet që përdoren në studimet Master në Kontabilitet në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës.

5. Analiza e pasqyrave financiare⁷

- Analiza e aktiveve dhe detyrimeve në pasqyrën e bilancit.
- Analiza e përfitueshmërisë, nëpërmjet studimit të të ardhurave e shpenzimeve të pasqyrës së të ardhurave e shpenzimeve.
- Cilësia e fitimit, analiza e likuiditetit – raportet statike dhe dinamike.
- Struktura e kapitalit dhe aftësia paguese.
- Analiza e treguesve të kthimit dhe analiza e perspektivës.
- Analiza e jetëgjatësisë, analiza e tregut.

Literatura:

Teksti ose leksionet që përdoren në studimet Master në Kontabilitet në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës.

⁵ Parashikohet që në tezën e provimit kjo pjesë e programit të përfshijë 15% të pikëve.

⁶ Parashikohet që në tezën e provimit kjo pjesë e programit të përfshijë 10% të pikëve.

⁷ Parashikohet që në tezën e provimit kjo pjesë e programit të përfshijë 10% të pikëve.

II. E DREJTA CIVILE, PENALE, LEGJISLACIONI TREGTAR DHE E DREJTA E PUNES NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE.

1. E Drejta civile – Kodi Civil dhe Kodi i Proçedurës civile⁸;
2. E Drejta Tregtare dhe e Shoqërive – Kodi Tregtar⁹;
3. E Drejta Penale – Kodi Penal dhe Proçedura Penale¹⁰;
4. E Drejta e Punës (Kodi i Punës) dhe sigurimet shoqërore¹¹;
5. Falimentimi dhe Proçedurat e tij¹²;
6. Parandalimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit¹³

Literatura:

1. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, pjesa II, III dhe IV;
2. Ligji Nr. Nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare;
3. Ligji Nr. Nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
4. Kodi Penal;
Pjesa e përgjithshme: Kreu I (nenet 1, 1/a, 1/b, 2, 3 dhe 4); Kreu II-të (nenet 12, 13, 14, 15, 16, 21); Kreu IV (nenet 25, 26, 27); Kreu V-të (nenet 29, 30, 32, 34, 35, 39, 40); Pjesa e posaçme: Kreu III (nenet 135, 143, 144, 163-170, 170/a, 171-179/a, 180-186, 192/a, 193-196); Kreu VIII (nenet 287, 287/a);
5. Kodi i Punës; Kreu IX dhe XI;
6. Ligji për sigurimet shoqërore - i ndryshuar;
7. Ligji “Për falimentimin”;
8. Ligji 9917, dt. 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar.

⁸ Parashikohet që në tezën e provimit kjo pjesë e programit të përfshijë 10 % të pikëve.

⁹ Parashikohet që në tezën e provimit kjo pjesë e programit të përfshijë 60 % të pikëve.

¹⁰ Parashikohet që në tezën e provimit kjo pjesë e programit të përfshijë 5 % të pikëve.

¹¹ Parashikohet që në tezën e provimit kjo pjesë e programit të përfshijë 10 % të pikëve.

¹² Parashikohet që në tezën e provimit kjo pjesë e programit të përfshijë 10 % të pikëve.

¹³ Parashikohet që në tezën e provimit kjo pjesë e programit të përfshijë 5 % të pikëve.

III - KODI I ETIKES PER PROFESIONISTET KONTABEL, SNKC¹⁴, SNA¹⁵, SNAR¹⁶

SNAS¹⁷ DHE STANDARDET PER ÇESHTJE SPECIFIKE, TE PUBLIKUARA NGA FEDERATA NDERKOMBETARE E KONTABILISTEVE.

1. Organizimi i profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar¹⁸

- Kushtet e hyrjes në profesionin e ekspertit kontabël të regjistruar;
- Objekti i veprimtarisë dhe kushtet që duhet të plotësohen për të ushtruar profesionin në praktikën publike. Lidhja midis profesionit dhe interesit publik dhe roli i tij në dhënien e sigurisë për palët e treta;
- Kërkesat kombëtare dhe europiane që rregullojnë organizimin e profesionit dhe ushtrimin e tij në praktikën publike;
- Koncepti i mbikëqyrjes publike dhe roli i saj;
- Kontrolli i cilësisë në nivel angazhimi, në nivel firme auditimi dhe roli i rishikimit të jashtëm

2. Etika profesionale¹⁹

- Konceptet bazë mbi etikën profesionale dhe dobinë që ajo ka për të garantuar përmbushjen e misionit publik të profesionit.
- Përdorimi i metodës konceptuale që bazohet në parimet etike bazë.
- Pavarësia dhe kërcenimet që i bëhen asaj.
- Masat mbrojtëse që garantojnë shërbime profesionale cilësore dhe të dobishëm për përdoruesit

3. Kryerja e një auditimi në pajtim me Standardet ndërkombëtare të auditimit të IAASB²⁰-së²¹

- Parimet e përgjithshme të auditimit dhe përgjegjësitë e audituesit, përcaktimi i kushteve të angazhimit të auditimit.
- Vlerësimi i rrezikut të anomalive materiale dhe reagimi ndaj rreziqeve të vlerësuara, Planifikimi dhe strategjia e auditimit.
- Evidentimi i auditimit, llojet e evidencës dhe procedurat që përdoren për sigurimin e saj, vlerësimi i përshtatshmerisë dhe mjaftueshmërisë së evidencës së auditimit.
- Përdorimi i punës së një audituesi tjetër, të audituesit të brendshëm dhe të ekspertëve.
- Konkluzionet dhe raportimi i auditimit – Llojet e raporteve, rastet e modifikimit të raporteve të audituesve të pavarur, raportimet në raste të vecanta.

4. Standardet profesionale të kryerjes së angazhimeve të tjera të sigurisë, rishikimit, etj, që ndryshojnë nga auditimi i informacioneve financiare historike²²

¹⁴ SNKC – Standardet ndërkombëtare të kontrollit të cilësisë.

¹⁵ SNA – Standardet Ndërkombëtare të Auditimit.

¹⁶ SNAR – Standardet ndërkombëtare të angazhimeve për të rishikuar.

¹⁷ SNAS – Standardet ndërkombëtare të angazhimeve të dhënies së sigurisë.

¹⁸ Parashikohet që në tezën e provimit kjo pjesë e programit të përfshijë 10 % të pikëve.

¹⁹ Parashikohet që në tezën e provimit kjo pjesë e programit të përfshijë 10 % të pikëve.

²⁰ Bordi i Standardeve ndërkombëtare të Auditimit e dhënies së sigurisë.

²¹ Parashikohet që në tezën e provimit kjo pjesë e programit të përfshijë 70 % të pikëve.

²² Parashikohet që në tezën e provimit kjo pjesë e programit të përfshijë 10 % të pikëve.

- Procedurat e kryerjes së angazhimeve për të rishikuar informacionet financiare historike, të angazhimeve të dhënies së sigurisë që ndryshojnë nga auditimi.
- Angazhimet për të hartuar informacionet financiare historike dhe ato të kryerjes së shërbimeve të lidhura e me procedura të pranuar nga palët.

Literatura:

1. *Ligji nr.10091, datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar";*
2. *Statuti dhe të gjitha rregulloret e IEKA-s;*
3. *Manuali i Deklaratave Ndërkombëtare të Kontrollit të Cilësisë, Auditimit, Rishikimit, Sigurive të Tjera dhe Shërbimeve të Lidhura, Botimi i vitit 2010;*
4. *Manuali i Kodit të Etikës për Profesionistët Kontabël i IFAC-ut, Botimi 2010 dhe Kodi i Etikës i IEKAs.*

IV - ORGANIZIMI, DREJTIMI, ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI I BRENDSHEM I PERSONAVE JURIDIKE, PERFSHIRE SISTEMET E INFORMACIONIT DHE TE INFORMATIKES.

1. Parimet bazë të organizimit, dhe administrimit të entiteteve të biznesit²³.

- Biznesi dhe format e organizimit, Mjedisi i jashtëm i biznesit, Natyra e manaxhimit, Planifikimi & Marrja e vendimeve, Natyra e organizimit dhe strukturimi organizativ i biznesit, Motivimi dhe udhëheqja, Manaxhimi i burimeve njerëzore, Kontrolli manaxherial i biznesit.

2. Sistemet e Informatikës dhe të kompjuterave²⁴;

3. Kontrolli i brendshëm, komponentët përbërës dhe organizimi i tij²⁵;

4. Qeverisja e Shoqërive tregtare, Roli i kodeve të mirëqeverisjes²⁶.

- Kuptimi mbi qeverisjen e korporatave; Bordi i drejtorëve/Këshilli mbikqyrës; Shpërblimi i manaxherëve në korporata; Audituesit dhe qeverisja e korporatave; Raportimi financiar dhe qeverisja e korporatave; Qeverisja e kompanive publike; Përgjegjësia sociale e korporatave & parimet e qeverisjes së mirë; Aspekte ndërkombëtare të qeverisjes së korporatave Modelet e QK; Globalizimi dhe efektet në qeverisjen e entiteteve.

Literatura:

1. *Tekstet që përdoren në Fakultetin e Ekonomisë, UT Tiranë nivel universitar dhe pasuniversitar për Manaxhimin, Qeverisjen e Korporatave, Sistemet e Informatikës dhe Etikën e biznesit;*
2. *SNA 315 - Pjesa që trajton kontrollin e brendshëm dhe komponentët e tij.*

²³ Parashikohet që në tezën e provimit kjo pjesë e programit të përfshijë 30 % të pikëve.

²⁴ Parashikohet që në tezën e provimit kjo pjesë e programit të përfshijë 10 % të pikëve.

²⁵ Parashikohet që në tezën e provimit kjo pjesë e programit të përfshijë 30 % të pikëve.

²⁶ Parashikohet që në tezën e provimit kjo pjesë e programit të përfshijë 30 % të pikëve.

V - LEGJISLACIONI FISKAL NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE.

1. Administrimi i detyrimeve tatimore në Republikën e Shqipërisë, procedurat që zbatohen për mbledhjen e tatimeve dhe detyrimeve të tjera tatimore. Struktura e tatimeve dhe taksave. Autoritetet përgjegjëse të taksave në nivel kombëtar e vendor²⁷.
2. Tatimet mbi të ardhurat²⁸;
3. Tatimi mbi vlerën e shtuar²⁹;
4. Taksat vendore direkte³⁰;
5. Akcizat dhe Taksat doganore³¹;
6. Kontributet e detyrueshme të Sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore³²;

Literatura:

1. *Faqja e internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në adresën: www.tatime.gov.al;*
2. *Fletoret Zyrtare ku janë botuar Udhëzimet e Ministrit të Financave për Sistemin Fiskal;*

²⁷ Parashikohet që në tezën e provimit kjo pjesë e programit të përfshijë 30 % të pikëve.

²⁸ Parashikohet që në tezën e provimit kjo pjesë e programit të përfshijë 25 % të pikëve.

²⁹ Parashikohet që në tezën e provimit kjo pjesë e programit të përfshijë 25 % të pikëve.

³⁰ Parashikohet që në tezën e provimit kjo pjesë e programit të përfshijë 5 % të pikëve.

³¹ Parashikohet që në tezën e provimit kjo pjesë e programit të përfshijë 5 % të pikëve.

³² Parashikohet që në tezën e provimit kjo pjesë e programit të përfshijë 10 % të pikëve.